

## **QENDRA PER KERKIM DHE ZHVILLIM**

Rr. "Luigj Gurakuqi", P.15/1, Sh.1, Ap.1

PO Box 218/1, Tirane

Tel&Fax: ++ 355 (0) 4 230 445

Mobile:++355 (0) 69 22 40 906

E-mail: qkzhtir@icc-al.org



*Raporti final per projektin:*

### **Opinionimi dhe Qendrimi i Qytetareve per Reformen Arsimore ne Shqiperi**

*Financuar nga:*

**Fondacioni per nje Shoqeri te Hapur, Tirane**

Tirane, Janar 2004

**Lista e tabelave**

**Lista e figurave**

**Falenderim**

**Gjetjet kryesore**

**Kapitulli i pare: Objektivat dhe metodologjia**

- 1.1 Hyrje
- 1.2 Justifikimi per projektin
- 1.3 Objektivat e projektit
- 1.4 Metodologjia
  - 1.4.1 Pergatitja e pyetesorit
  - 1.4.2 Percaktimi i kampionit te te anketuarve

**Kapitulli i dyte: Perzgjedhja e kampionit**

- 2.1 Shperndarja e panelit sipas kategorive te vecanta

**Kapitulli i trete: Rezultatet e pergjithshme te anketimit**

- 3.1 Hyrje
- 3.2 Informimi per reformen arsimore dhe rruget e marrjes se informacionit
- 3.3 Vlerat dhe dobesite e sistemit arsimor
- 3.4 Politika dhe konkurueshmeria
- 3.5 Ngarkesa mesimore
- 3.6 Kushtet e mesimdhenies, shperblimi dhe financimi
- 3.7 Drejtimi i shkollave, sistemi dhe dy-punesimi

**Kapitulli i katert: Opinioni i arsimtareve dhe nxenesve**

- 4.1 Hyrje
- 4.2 Informimi, vlerat dhe dobesite e sistemit te sotem arsimor
- 4.3 Opinion i mesuesve/nxenesve per ngarkesen mesimore
- 4.4 Numri i nxenesve dhe puna drejtuese

**Kapitulli i peste: Konkluzione**

## Lista e tabelave

- Tabela 1: Opinioni sipas gjinise mbi shkallen e informimit te publikut per reformen arsimore ne Shqiperi
- Tabela 2: Opinioni sipas gjinise mbi burimet e informacionit per reformen ne arsim
- Tabela 3: Opinioni sipas gjinise mbi vlerat e sotme te sistemit arsimor
- Tabela 4: Opinioni sipas gjinise mbi mangesite qe shfaqen ne sistemin e sotem arsimor
- Tabela 5: Opinioni sipas gjinise mbi vemendjen qe i kushton politika reformes arsimore
- Tabela 6: Opinioni sipas gjinise mbi cilesine dhe konkurueshmerine jashte vendit e programeve arsimore
- Tabela 7: Opinioni sipas gjinise mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e fillores
- Tabela 8: Opinioni sipas gjinise mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e dyte te 8-vjecares
- Tabela 9: Opinioni sipas gjinise mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per shkollat e mesme te pergjithshme
- Tabela 10: Opinioni sipas gjinise mbi vleresimin per numrin 20 nxenes per nje mesues
- Tabela 11: Opinioni sipas gjinise mbi vleresimin per shperblimin e mesuesit per punen e kryer
- Tabela 12: Opinioni sipas gjinise mbi nevojat per kualifikim te vazhdueshem e arsimtareve
- Tabela 13: Opinioni sipas gjinise mbi vleresimin e bazes materiale-didaktiko si nje kusht i rendesishem per nje reforme te suksesshme arsimore
- Tabela 14: Opinioni sipas gjinise mbi vleresimin per numrin e nxenesve ne nje klase ne kushte optimale
- Tabela 15: Opinioni sipas gjinise mbi burimet nga duhet e financohet shkolla
- Tabela 16: Opinioni sipas gjinise mbi vleresimi se si e organizojne dhe e drejtojne punen drejtoret e shkollave
- Tabela 17: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi shkallen e informimit per reformen arsimore ne Shqiperi
- Tabela 18: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi burimet e informacionit per reformen ne arsim
- Tabela 19: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi vlerat e sotme te sistemit arsimor
- Tabela 20: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi mangesite qe shfaqen ne sistemin e sotem arsimor
- Tabela 21: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi cilesine dhe konkurueshmerine jashte vendit e programeve arsimore
- Tabela 22: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e fillores
- Tabela 23: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e dyte te 8-vjecares
- Tabela 24: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per shkollat e mesme te pergjithshme
- Tabela 25: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi vleresimin per numrin e nxenesve ne nje klase ne kushte optimale
- Tabela 26: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi vleresimi se si e organizojne dhe e drejtojne punen drejtoret e shkollave
- Tabela 27: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi sistemin e detyruar arsimor
- Tabela 28: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi ndikimin ne mesimdhenie te dy-punesimit te arsimtareve

## Lista e figurave

- Fig. 1: Shperndarja sipas gjinise
- Fig. 2: Shperndarja sipas grup-moshave
- Fig. 3: Shperndarja sipas arsimit
- Fig. 4: Shperndarja sipas profesioneve
- Fig. 5: Shperndarja sipas rretheve
- Fig. 6: Shperndarja sipas vendbanimit
- Fig. 7: Shkalla e informimit te publikut per reformen arsimore ne Shqiperi
- Fig. 8: Burimet e informacionit per reformen ne arsim
- Fig. 9: Vlerat e sotme te sistemit arsimor
- Fig. 10: Mangesite qe shfaqen ne sistemin e sotem arsimor
- Fig. 11: Vemendja qe i kushton politika reformes arsimore
- Fig. 12: Cilesia dhe konkurueshmeria jashte vendit e programeve arsimore
- Fig. 13: Ngarkesa e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e filllores
- Fig. 14: Ngarkesa e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e dyte te 8-vjecares
- Fig. 15: Ngarkesa e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per shkollat e mesme te pergjithshme
- Fig. 16: Vleresimi per numrin 20 nxenes per nje mesues
- Fig. 17: Vleresimi per shperblimin e mesuesit per punen e kryer
- Fig. 18: Nevoja per kualifikim te vazhdueshem e arsimtareve
- Fig. 19: Vleresimi i bazeve materiale-didaktike si nje kusht i rendesishem per nje reforme te sukseshme arsimore
- Fig. 20: Nevoja per rritjen e numrit te kopshteve
- Fig. 21: Nevoja per rritjen e numrit te shkollave 8-vjecare
- Fig. 22: Nevoja per rritjen e numrit te shkollave te mesme te pergjithshme
- Fig. 23: Vleresimi per numrin e nxenesve ne nje klase ne kushte optimale
- Fig. 24: Burimet nga duhet e financohet shkolla
- Fig. 25: Opinioni mbi nivelin 10% te shpenzimeve per arsimin nga buxheti i shtetit
- Fig. 26: Vleresimi se si e organizojne dhe e drejtojne punen drejtoret e shkollave
- Fig. 27: Menyra e emerimit te drejtoresh te shkollave
- Fig. 28: Opinioni mbi sistemin e detyruar arsimor
- Fig. 29: Ndikimi ne mesimdhenie i dy-punesimit te arsimtareve
- Fig. 30: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi shkallen e informimit per reformen arsimore ne Shqiperi
- Fig. 31: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi burimet e informacionit per reformen ne arsim
- Fig. 32: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi vlerat e sotme te sistemit arsimor
- Fig. 33: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi mangesite qe shfaqen ne sistemin e sotem arsimor
- Fig. 34: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi cilesine dhe konkurueshmerine jashte vendit e programeve arsimore
- Fig. 35: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e filllores
- Fig. 36: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e dyte te 8-vjecares
- Fig. 37: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per shkollat e mesme te pergjithshme
- Fig. 38: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi vleresimin per numrin e nxenesve ne nje klase ne kushte optimale
- Fig. 39: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi vleresimi se si e organizojne dhe e drejtojne punen drejtoret e shkollave
- Fig. 40: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi menyrat e emerimit te drejtoresh te shkollave
- Fig. 41: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi sistemin e detyruar arsimor
- Fig. 42: Opinioni i punonjesve te arsimit mbi ndikimin ne mesimdhenie te dy-punesimit te arsimtareve

## **Falenderim**

Grupi i punes i perbere nga Albert Gajo, Mirlinda Rusi dhe Rozi Poga falenderojne ne menyre te vecante zj. Mimoza Gjika ne Fonacionin per nje Shoqeri te Hapur, per sigurimin e materjaleve suplementare per projekte te ngjashme ne vendet e tjera te rajonit, si dhe verejtjet dhe sugjerimet e saj ne pergatitjen e pyetesorit. Falenderojme gjithashtu z. Stavri Llambiri, Kryetar i rrethit te Shoqatave te Arsimit, per verejtjet dhe sugjerimet e tij gjate fazes se pergatitjes se raportit perfundimtar dhe se fundi, por jo nga rendesia e kontributit te tyre, duhet te falenderojme z. Sotir Rapo ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences dhe zj. Flutra Sheshi ne Drejtorine Arsimore per mbeshtetjen e tyre gjate fazes fillestare te projektit dhe ne hartimin e pyetesorit.

## **Gjetjet kryesore**

### **Shkalla e informimit**

Me shume se gjysma e te intervistuarve nuk kane informimin e mjaftueshem per reformen arsimore ne Shqiperi. Ne kete aspekt femrat jane me te informuara se sa meshkujt. Mesuesit dhe deri diku nxenesit jane me te mireinformuar per reformen arsimore.

### **Burimet e informimit**

Burimi kryesor i marrjes se informacionit nga individet e ndryshem eshte televizioni, dhe me pas shtypi. Kontakti i prinderve me arsimtaret nuk u jep atyre ndonje avantazh ne sigurimin e informacionit per reformen arsimore, burim i cili eshte ne nje nivel edhe me te ulet se informimi nga nxenesit. Gjithashtu, burimi kryesor i informimit per mesuesit dhe nxenesit mbetet media e shkruar dhe ajo vizive. Per nxenesit dhe studentet mesuesit jane nje tjeter burim i rendesishem i informimit, ndersa per keta te fundit duket se mungojne kanalet e komunikimit ndermjet trupes pedagogjike, drejtorive arsimore dhe ministrise perkatese.

### **Cilesite pozitive**

Vleresimin per sistemin e sotem arsimor te intervistuarit e lidhin me teper me sigurine qe u krijon ai per pune si dhe per vlerat edukuese te tij. Punonjesit e arsimit ndajne pothuajse te njetin mendim me grupet e tjera te intervistuarve ne lidhje me vlerat e sistemit te sotem arsimor. Ata vleresojne dicka me shume programet e mira arsimore. Nxenesit kane nje shperndarje me uniforme ndermjet vlerave te ndryshme te sistemit te sotem arsimor.

### **Mangesite**

Ndersa si dobesi te tij dalin ne pah vecanerisht paisja e dobet e shkollave dhe numri i madh i nxenesve ne shkolla. Meshkujt shikojne gjithashtu si problem te rendesishem shperblimin e ulet te arsimitareve. Per mbi 75% e arsimitareve mendojne se arsimi ka 3 te meta kryesore, rrogat e uleta, numrin e madh te nxenesve ne klasa dhe paisjen e dobet te shkollave, ndersa nxenesit duket se kane me shume problem paisjen e dobet te shkollave dhe dicka me pak, numri e nxenesve ne klasa.

### **Ngarkesa mesimore**

Te anketuarit mendojne se cikli i ulet i shkolles 8 vjecare dhe shkolla e mesme e pergjithshme kane ngarkesen me te madhe mesimore, kundrejt ciklit te larte te shkolles 8-vjecare. Perqindja e atyre qe thone se shkolla eshte mjaft e ngarkuar lidhet me ngarkesen mesimore te shkolles se mesme te pergjithshme. Meshkujt dhe femrat ndajne pothuajse te njetin mendim per shkollen e meseme te pergjithshem, ndersa meshkujt mendojne se shkolla 8 vjecare ne te dy ciklet eshte me e ngarkuar, perkundrejt mendimit te femrave. Opinioni i mesuesve dhe nxenesve ne pergjithesi perputhet me ate te grupeve te tjera ne ngarkesen e larte per shkollen e mesme te pergjithshme, ndersa ka disa difference ne dy ciklet e shkolles 8-vjecare.

### **Numri i nxenesve ne nje klase**

Pothuajse 100% e te anketuarve mendojne se numri i nxenesve ne nje klase duhet te jete me i vogel se 30 nxenes. Pjesa me e madhe e te anketuarve mendojne se ky numer duhet te varioje ne 16-25 nxenes per nje klase. Per mesuesit duket se numri me i pershtshem ne klase eshte ai me 21-25 nxenes, ndersa nxenesit dhe studentet mendojne se ky numer duhet te jete edhe me i ulet.

### **Financimi**

Vetem 7% e te anketuarve mendojne se shkollat duhet te financohen nga burimet e buxhetit lokal apo private. Pjesa me e madhe e tyre preferon qe shkolla te financohet nga burime te perziera. Rreth 96% e te anketuarve mendojne se ne arsimin duhet te alokohen me shume se 10% e totalit te shpenzimeve buxhetore.

### **Drejtimi i shkollave**

Opinioni i te anketuarve per drejtimin e shkollave nga drejtoret eshte pothuajse i ndare ne menyre te barabarte, pasi gjysma e tyre mendojne se ky drejtim eshte i mire dhe shume i mire, ndersa pjesa tjeter nuk eshte e kenaqur nga ky drejtim. Pjesa me e madhe e te intervistuarve, ose 95%, mendojne se drejtoret e shkollave duhet te caktohen me konkurim dhe jo me emerim. Mesuesit kane nje mendim pozitiv per drejtimin e shkollave nga drejtoret, pasi rreth 85% e tyre mendojne se ata e drejtojne mire ose shume mire shkollen. Rreth 95% e punonjesve te arsimit qe jane intervistuar mendojne se konkursi eshte forma me e parshtshme per emerimin e drejtoreve.

### **Sistemi arsimor detyrues**

Te intervistuarit duket se preferojne nje sistem te detyrueshem arsimor pak me te gjate se ai qe ka menduar Ministria e Arsimit, pasi preferenca e tyre eshte per nje arsim 10 vjecar, kundrejt atij 9 vjecar qe duket se ka zgjedhur ministria perkatese. Rreth 54% e mesuesve mendojne se sistemi arsimor i detyruar me i pershtshem eshte ai 10 vjecar, ndersa 19% e tyre mendojne se me i pershtatshmi eshte ai 9-vjecar.

### **Dy-punesimi i arsimtareve**

Rreth 85% e te intervistuarve mendojne se dy-punesimi i arsimtareve ka ndikim jo te mire ne mesimdhenie. Ne shumicen e tyre punonjesit e arsimit mendojne se dy-punesimi ka ndikim negativ mbi mesimedhenien, ndersa rreth 41% te tyre mendojne se dy-punesimi nuk ka ndikim ose ka ndikim pozitiv per mesimdhenien.

# Kapitulli i pare

## Objektivat dhe Metodologjia

### 1.1 Hyrje

Gjate dhjete vjeteve te fundit sistemi arsimor ne Shqiperi ka pesuar transformime te rendesishme qe lidhen jo vetem me ndryshimet e programeve mesimore per t'ju pershtatur transformimeve social-politike, por edhe permiresimeve qe lidhen me harmonizimin e ketyre programeve me standartet Europiane. Pavaresisht nga keto ndryshime dhe permiresime ne kuadrin e e reformes arsimore, ky sektor po ballafaqohet me probleme te shumta qe lidhen me levizjet e medha demografike qe kane ndodhur sidomos ne rrethet e Tiranës dhe Durresit, ku popullsia e ketyre qyteteve pothuajse eshte dyfishuar, ka nje renie te frekuentimit te shkollave te ciklit te ulet dhe mesem, si dhe probleme te tjera qe lidhen me etiken dhe sjelljen e mesuesve. Duke u nisur nga rendesia e vecante qe ka arsimit per perparimin dhe zhvillimin e vendit si dhe nga problematika e gjere dhe e larmishme qe ekziston per zhvillimin e ketij sektori, ka bere qe nga ana e institucioneve perkatese shtetore te ndertohen dhe ndermerren mjaft iniciative, por qe nuk jane te njohura nga ana e publikut, qe eshte edhe perfituesi kryesor i ketij sistemi. Pikerisht, projekti i propozuar kishte per qellim te diagnostikonte si dhe sa publiku Shqiptar eshte i njohur me reformen arsimore ne Shqiperi, si e vlereson kete reforme ne krahasim me reformat e tjera, dobesite te ketij sistemi dhe drejtimet kryesore se ku duhet te nderhyhet me shpejt dhe me pare per te arritur efektet me te madha me burimet ekzistuese financiare. Projekti u mbeshet mbi nje anketim te zgjeruar te mbi 1000 individeve te grup-moshave mbi 18 vjec, te cilat u perzgjedhen ne menyre te rastesishme ne rrethet kryesore te Shqiperise, si Tirane, Durres, Shkoder dhe Elbasani. Anketimi u zhvilluar gjate periudhes 10 Nentor deri me 10 Dhjetor 2003. Analiza e te dhenave te anketes u krye gjithashtu e ndare sipas grup moshave, gjinise, arsimit dhe rretheve perkatese. Projekti synon ti sherbeje jo vetem Ministrise se Arsimit dhe Shkences, por edhe instituteve kerkimore dhe shkencore, studiuvesve te ndryshem, anetareve te parlamentit dhe lobeve te tjere te interesuar per zhvillimin e arsimit ne Shqiperi.

### 1.2 Justifikimi per projektin

Arsimi eshte nje nga hallkat me te rendesishme qe siguron transmetimin e dijeve dhe njohurive ne nje shoqeri te caktuar, e cila siguron nga ana e saj rritjen e aftesive te qytetareve per te shfrytezuar me mire aftesite e tyre per sigurimin e mireqenies individuale dhe kolektive te shoqerise. Nga ana tjetere sistemi arsimor eshte mjaft kompleks dhe i nderthurur me trashegimine, traditen, kushtet aktuale, ndryshimet socio-ekonomike qe ndodhin brenda dhe jashte vendit, qe gje nenkupton se ky sistem eshte ne nje proces dinamik te ndryshueshem. Por ndryshimet dhe permiresimet qe kerkohen te behen ne momente te caktuara jo vetem qe kane nje kosto relativisht te madhe financiare, por edhe duhet te behen ne perputhje me nevojat me emergjente dhe qe plotesojne njekohesisht edhe nevojat per ndryshime graduale per te ardhmen. Por jo gjithmone prioritete per ndryshime jane ne perputhje me nevojat reale. Per te gjykuar ne se keto ndryshimeve kane qene te domosdoshme, eshte e nevojshme te kryhen testimet dhe krahasueshmeri te rezultateve me ane te indikatorëve te ndryshem qe pasqyrojne nivelin e zhvillimit te arsimit ne nivele te caktuara. Nje nga keto testimet eshte edhe marrja ose terheqja e mendimit te qytetareve per reformen arsimore qe po zhvillohet deri tani.

Terheqja e mendimit te qytetareve per reformen arsimore eshte i rendesishem pasi:

1. Publiku eshte perfituesi i drejperdrejte i arsimit dhe si i tille eshte "gryqtari" me i paanshem i progresit qe po behet ne reformen e arsimore.
2. Nga perpunimi i te dhenave per kategori te ndryshme qytetaresh gjykohet me drejte per arritet dhe mangesite, duke gjykuar sidomos per hallkat me te dobete te sistemit arsimor, gje qe do te rriste efencen e reformes arsimore.



3. Sigurohet nje informacion mbi shkallen e informimit te publikut mbi reformen arsimore, duke vleresuar ne kete menyre progresin qe ka ministria perkatese per te bere te njohur prioritetet dhe objektivat e reformes arsimore.
4. Jepet nje mendim i sakte per mundesine e delegimit te nje pjese te administrates se shkollave ne nivel te pushtetit vendor.

Vleresime te tilla te ngjashme per ecurine e reformes arsimore nepermjet gjykimit dhe opinioneve te qytetareve behen edhe nga vendet e zhvilluara dhe ato ne tranzicion. Nje projekt i ngjashem me kete projekt eshte zbatuar edhe ne Mal te Zi, i cili u vleresua mjaft per perfundimet e nxjera nga studimi perkates.

### 1.3 Objektivat e projektit

Me ane te ketij projekti u synua te realizohen objektivat e meposhtme:

1. Te njihet shkalla e informimit te publikut per reformen arsimore ne Shqiperi
2. Te mundesohet identifikimi i dobesive me kryesore qe verehen ne sistemin e arsimit.
3. Evidentimin i efikasitetit te sistemit te sotem arsimor.
4. Percaktimin e raportit qe duhet te ekzistojte mbi permiresimin e programeve, metoden e mesimmedhenies, ngarkesa per nje mesues, si dhe permiresimet e bazes pedagogjike.
5. Vleresimin e etikes se stafit pedagogjik ne raport me sherbimet e tjera qe i jepen publikut.
6. Te rritet informacioni qe ka Ministria e Arsimit dhe Shkences ne lidhje me ndryshimet eventuale qe duhet te ndermerren per permiresimet e sistemit arsimor.
7. Se fundi, te nxise dialogun ndermjet perfaqesuesve te Ministrise se Arsimit dhe Shkences dhe grupeve te ndryshme kerkimore shkencore ne fushen e studimeve pedagogjike dhe politikave te perdorimit te buxhetit te shtetit.

### 1.4 Metodologjia

Rezultatet e ketij projekti u bazuan ne perpunimin e informacionit te marre nga anketimi i rreth 1000 individeve. Per te bere te mundur kete paraprakisht u pergatit (1) pyetesori, qe te mbulonte gjithë tematiken e kerkuar per te realizuar objektivat e ketij projekti ne lidhje me reformen arsimore; (2) se dyti u percaktuan kriteret mbi te cilet do te perzgjidhen individet e perfshire ne anketim; si dhe u percaktuan (3) kriteret e vleresimit dhe paraqitjes se rezultateve te anketimit. Me poshte do te ndalemi ne te tre keto elemente te rendesishem te metodologjise se ketij projekti.

#### 1.4.1 Pergatitja e pyetesorit

Pyetesori u organizua me disa seksione pyetjesh me permbajtjen e meposhtme:

##### *I. Pyetjet verifikuese*

Me anë te ketyre pyetjeve u be e mundur të mblidhet informacion ne lidhje me:

- § Grup moshen ku bënte pjesë i anketuari
- § Arsimi
- § Profesioni
- § Seksi
- § Lidhjet e te anketuarit me shkollen

##### *II. Pyetje mbi shkallen e informimit mbi reformen arsimore, ne te cilen u kerkua informacion mbi:*

- § Periudhen e njohjes se reformes arsimore
- § Vleresimin e shkalles se informacionit
- § Burimet e marrjes se informacionit
- § Arsyet e marrjes se informacionit

**III. Vleresimi i reformes se arsimit u realizua nepermjet pyetjeve qe evidentojne:**

- § Rendesine e tij
- § Shanset per te patur sukses reforma ne arsim
- § Rendesia qe i jep publiku reformes ne arsim

**IV. Vleresimi i mangesive kryesore te sistemit arsimor, ne te cilat u dalluan:**

- § Shkaku i mangesive (aresyhet financiare, metodologjike etj)
- § Natyra e magesive

**V. Vleresimin e reformes arsimore nga:**

- § Ministria perkatese
- § Klasa politike

**VI. Aspekte te vecanta te reformes arsimore, si:**

- § Ngarkesa arsimore
- § Vleresimi i profesioneve
- § Shperblimi per arsimtaret
- § Kualifikimi
- § Baza materjalo-teknike
- § Kushtet e pergjithshme
- § Aspektet financiare

**1.4.2 Percaktimi i kampionit te te anketuarëve**


Për t'ju pergjigjur kerkesave per te marre nje informacion sa me perfaqesues, u anketuan 1000 qytetare te moshes mbi 18 vjec. Perzgjedhja e tyre u be ne rreth 80% ne zonat urbane ne qytetet kryesore te vendit si Tirana, Durresi, Shkodra, Elbansani, Fieri dhe Vlora, ndersa 20 % u perzgjedhen nga zonat rurale te rretheve respektive. Po keshtu u respektua nje shperndarje pothuajse e barabarte sipas gjinise. Percaktimi i kampionit të të anketuarve per çdo zone urbane u realizua sipas dendesise se popullsise per cdo qytet, duke marre parasysh rregjistrimin e fundit te popullsise se realizuar nga INSTAT. Po keshtu u respektua edhe shpendarja sipas profesioneve dhe moshes, ndersa shpendarja e te anketuarve sipas arsimit u realizua duke marre parasysh nje rritje te perfaqesimit te anketuarve me shkolle te larte ne krahasim me ate te 8-vjecare. Ne kapitullin e dyte pasqyrohen me detaje shperndarja e te anketuarve sipas kategorive te ndryshme.

### Perzgjedhja e kampionit

#### 2.1 Shperndarja e panelit sipas kategorive te vecanta


Sic u theksua edhe ne kaptullin e pare perzgjedhja e kampionit te te intervistuarve u krye ne baze disa kriterëve, si ai i shperndarjes demografike te popullsisë, profesionit, arsimit, territorit, te cilat do te pasqyrohen me ne hollesi ne kete kapitull.

Nga figura 1 shikohet se ne lidhje me shperndarjen sipas gjinise eshte ruajtur kriteri i barazise ndermjet te anketuarve meshkuj dhe femra, pasi afersisht 48 % e te anketuarve ishin meshkuj dhe 52% femra.



Burimi: Qkzh, Tirane


Figura 2 tregon shperndarjen e panelit sipas moshave. Edhe per kete kriter eshte ruajtur pak a shume shperndarja demografike. Keshtu 34 % e te anektuarve e perbejne te rinjte e moshes 18-30 vjec, 23% ate te moshes 31-40, 27 % te moshes 41-50, 11 % te moshes 51-60 dhe vetem 5% e samplit eshte e moshes mbi 60 vjec.



Burimi: Qkzh, Tirane


Ne lidhje me perzgjedhjen e kampionit sipas kriterit te arsimit, nga ana e grupit te punes u mendua te shtohen kategorite e te anketuarve me arsim te larte dhe te mesem, kundrejt atyre me arsim 8-vjecar

dhe te pa arsim, me synimin per te marre pergjigje me precize per cilesine dhe ecurine e reformes se sotme ne arsim. Keshtu nga figura 3 shikohet se 48 % e te anketuarve jane me arsim te mesem, 38% me arsimin e larte, 13 % me arsimin 8-vjecar dhe vetem 1% pa arsim.




Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 4 tregon shperndarjen e te anketuarve sipas profesioneve. Grupimin me te madh me 26 % e zene te punesuarit ne sektorin privat. Pas tyre e zene pronaret individuale dhe nxenesit e studentet me respektivisht 17 % dhe 16 %. Nje grup i rëndësishem i perzgjedhur ne kete panel eshte edhe grupi i punonjesve te arsimit (kryesisht mesues ne shkollat e mesme te pergjithshme dhe 8-vjecare), qe perbejne rreth 7 % te kampionit te te anketuarve.




Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 5 tregon shperndarjen sipas rajoneve gjeografike. Kuptohet qe pjesa me e madhe e te anketuarve ose 51 % e tyre jane nga qyteti dhe fshatrat e Tiranës. Ndersa shperndarja ne rrethet e tjera eshte bere pothuajse e barabarte dhe varion ne rreth 16-17 % te kampionit per cdo rreth.



Burimi: Qkzh, Tirane

Kriteri i fundit i shperndarjes se kampionit ishte shperndarja sipas vendbanimit, qytet fshat. Ne baze te metodologjise se perzgjedhur, pjesa me e madhe e te intervistuarve, ose 82 % e tyre i takon zonave urbane dhe pjesa tjeter prej 18 % jane individe qe aktualisht banojne ne fshat (shiko figuren 6).



Burimi: Qkzh, Tirane

Si konkluzion per kete kapitull mund te thuhet se perzgjedhja e kampionit te anketuarve u krye konform metodologjise se hartuar paraprakisht, e cila duhet te lejonte nje shperndarja te te intervistuarve sipas karakteristikave demografike, por edhe per te lejuar marrjen e opiniononeve, nga individe qe jane me afer problemeve dhe reformes ne arsim, duke rritur ne kete menyre pjesemarrjen ne anketim te individeve me arsim te larte dhe te mesem te pergjithshem, te punonjesve te arsimit, dhe duke rritur pjesemarrjesit nga zonat urbane.

### Rezultatet e pergjithshme te anketimit

#### 3.1 Hyrje


Cdo reforme qe ndermerret ne nje sistem te caktuar qe siguron sherbime per publikun ka per qellim qe te plotesoje me mire nevojat e ketij te fundit per keto sherbime. Per kete qellim cdo institucion qe eshte pergjegjes per mbarevajtjen e ketej sistem eshte e nevojshme jo vetem te njohe situaten dhe nevojat, por te gjeje rruget dhe percaktoje politikat e duhura per permiresimet e duhura. Kjo eshte shume e domosdoshme ne sherbime te tilla si ai i arsimit, pasi dobesite e ketij sistemi do te ndikojne ne menyre te drejperdrejte ne stabilitetin dhe zhvillim afat gjate ekonomik dhe social te vendit. Nga ana tjeter njohja e kesaj reforme nga ana e publikut eshte po ashtu mjaft e rendesishme, pasi ne kete menyre sigurohet:

- nje vleresim me i mire i suksesit (apo deshtimit) te reformes arsimore;
- siguron nje pjesemarrje me te mire te grupeve te interesuara ne kete reforme (ne vecanti punonjesit e arsimit, nxenesit dhe studentet si dhe komuniteti i prinderve, i cili gjithashtu eshte komponent shume i rendesishem);
- sigurohet marrja e nje informacioni me te gjere dhe me te sakte mbi dobesite dhe te metat e sistemit arsimor;
- dhe se fundi, por jo nga rendesia, duke siguruar nje pjesemarrje te vazhdueshme te publikut ne cdo hallke te reformes arsimore, mund te behen edhe korrigjimet eventuale te te metave dhe dobesive te vete strategjise qe eshte perzgjedhur per te kryer reformen arsimore.

Ne kete kapitull do te pasqyrohen rezultatet e pergjithshme te anketimit per te gjitha grup pyetjet e bera ne pyetesor, duke bere edhe nje klasifikim te pergjigjeve sipas gjinise, meshkuj-femra. Kjo ndarje behet per te pare jo vetem diferencen e opinioneve ndermjet ketyre dy kategorive, por edhe per te gjykuar mbi mendimin e femrave, pasi ne traditen e familjes shqiptare ne pjesen me te madhe jane ato qe jane me afer perkujdesit dhe mbarevajtjes se femijeve ne shkolle.

#### 3.2 Informimi per reformen arsimore dhe rruget e marrjes se informacionit

Ne figuren 7 pasqyrohen rezultatet e pergjithshme ne lidhje me pyetjen se sa jane te informuar te intervistuarit per reformen arsimore ne Shqiperi. Nga figura duket se rreth 57 % e te intervistuarve jane pak ose aspak te informuar per reformen arsimore ne Shqiperi, ndersa 32 % e tyre kane nje informacion te mjaftueshem dhe vetem 11 % jane te mireinformuar per reformen arsimore ne Shqiperi.



Burimi: Qkzh, Tirane

Nga tabela 1 duket ne menyre te qarte se femrat jane shume me te informuara se sa meshkujt per zhvillimet e reformes arsimore, gje qe provon deri diku qe gruaja perkujdeset dhe ndjek me shume mbarevajtjen e femijeve ne shkolle, gje qe e ben ate me te interesuar per te njohur zhvillimet e reformes arsimore.


Tabela 1: Opinioni sipas gjinise mbi shkallen e informimit te publikut per reformen arsimore ne Shqiperi

	I mire informuar	Mjaftueshem	Pak	Aspak
Meshkuj	10%	28%	49%	13%
Femra	11%	37%	40%	12%

Burimi: QKZH Tirane

Nga tabela shikohet se informacion te mjaftueshem kane 37 % e te intervistuarave, kundrejt 28 % te meshkujve. Megjithate, perseri me shume se gjysma e femrave te intervistuarave, ose 52 % e tyre jane pak ose aspak te informuara per reformen arsimore.

Figura 8 tregon rezultatet e pergjigjeve ne lidhje me burimet nga te cilat merret informacioni ne lidhje me reformen arsimore. Nga figura shikohet se kanali kryesor per marrjen e informacionit nga publiku per kete ceshtje eshte televizioni, pasi 58 % e te intervistuarave kane cilesuar kete burim si marres informacioni. Vendiin e dyte e ze shtypi si burim informacioni me 35 %, ndersa kontakti me femijet vetem 25 % (duhet te kihet parasysh se ky tregues eshte relativisht i ulet, pasi nje pjese e mire e te intervistuarave jane nxenes/ studente dhe ndoshta edhe madhore por pa femije).



Shenim: Mund te zgjidhen me shume se nje pergjigje

Burimi: Qkzh, Tirane

Kontaktet me mesuesit zene vetem 18 %, qe eshte ne nje nivel me te ulet se ai qe sigurohet nga vete femija.

Te njejta rezultate, te ndara sipas gjinise jepen ne tablen 2. Nga tabela duket qe meshkujt lexojne me shume gazetate dhe per rrjedhoje 37 % e tyre e marrin kete informacion nga shtypi, kundrejt 32 % nga femrat. Po keshtu duket se kontaktet me mesuesit i kane me te shpeshta meshkujt pasi 19% e tyre deklarojne se i marrin informacionit nga mesuesit kundrejt 17 % te femrave. Sic mund te kuptohet femra kane nje avantazh tek femijet ne marrjen e informacionit me 24 %, kundrejt 21 % te meshkujve.

Tabela 2: Opinioni sipas gjinise mbi burimet e informacionit per reformen ne arsim

	Nga femijet tuaj	Nga kontakti me mesuesit	Nga te njohurit	Nga shtypi	Nga televizioni	Te tjera
Meshkuj	21%	19%	17%	37%	56%	0.4%
Femra	24%	17%	22%	32%	60%	0.7%


Shenim: Mund te zgjidhen me shume se nje pergjigje

Burimi: QKZH Tirane

Si perfundim te ketij seksioni mund te thuhet se me shume se gjysma e te intervistuarve nuk kane informimin e mjaftueshem per reformen arsimore ne Shqiperi. Ne kete aspekt femrat jane me te informuara se sa meshkujt. Burimi kryesor i marrjes se informacionit nga individet e ndryshem eshte televizioni, dhe me pas shtypi. Kontakti i prinderve me arsimtaret nuk u jep atyre ndonje avantazh ne sigurimin e informacionit per reformen arsimore, burim i cili eshte ne nje nivel edhe me te ulet se informimi nga nxenesit.

### 3.3 Vlerat dhe dobesite e sistemit arsimor

Figura 9 pasqyron rezultatet e pyetjes ne lidhje me vlerat e sistemit te tanishem arsimor. Nga figura shikohet se vleresimin maksimal, ose 46 % e te anketuarve, sistemi arsimor e ka marre pasi ai u siguron te interesuarve te ardhme me te sigurte per punesimin e tyre.



Shenim: Mund te zgjidhen deri ne 2 pergjigje  
Burimi: Qkzh, Tirane

Legjenda:

- |   |  |   |                           |
|---|--|---|---------------------------|
| 1 | Shkollimi i lire                                     | 5 | E ardhme e sigurte pune   |
| 2 | Arsim i gjere dhe masiv                              | 6 | Te tjera                  |
| 3 | Program i mire arsimor                               | 7 | Nuk kam mendim te vecante |
| 4 | Ndikimi i madh i shkolles ne edukimin e brezit te ri |   |                           |

Sipas opiniononeve te mbledhura, vlere tjetere rendesishme e sistemit te sistemit arsimor konsiderohet, ndikimi qe ka arsimi ne edukimin e brezit te ri. Vleresimi me i ulet eshte per programin arsimor te shkolles e cila cilesohet si vlere pozitive e shkolles nga vetem 17 % e te intervistuarve.

Tabela 3: Opinioni sipas gjinise mbi vlerat e sotme te sistemit arsimor

	1	2	3	4	5	6	7
Meshkuj	23%	26%	17%	43%	50%	0%	2%
Femra	26%	25%	17%	41%	43%	0%	7%


Shenim: Mund te zgjidhen deri ne 2 pergjigje  
Burimi: Qkzh, Tirane

Meshkujt kane shprehur nje opinion vleresues me te madh se femrat per mundesine per pune qe te siguron arsimi (shiko tabelen 3), i cili eshte permendur nga 50 % e meshkujve kundrejt 43 % nga femrat. Femrat shikojne si vlere me te madhe te arsimit faktin se arsimimi eshte relativisht i lire, ndersa ne opionet e tjera ata ndajne pothuajse te njejtin mendim.

Te metat kryesore ne sistemin e sotem arsimor nga te intervistuarit shikohen me shume ne infrastrukturen mbeshtetese te shkolles. Keshtu sipas figures 10 shikohet se problemi i paisjes se dobet



te shkollave dhe numri i madh i nxenesve ne klasa shikohen si pengesa respektivisht nga 66 % e te intervistuarve, ndersa nje vend pothuajse te njejte e zene pergjigjet persa i perket rrogave te uleta te arsimtareve.



Shenim: Mund te zgjidhen deri ne 3 pergjigje  
Burimi: Qkzh, Tirane

Legjenda:

- |   |   |    |  |
|---|---|----|--|
| 1 | Paisja e dobet e shkollave                  | 6  | Kriteri i pabarabarte i vleresimit te nxenesve                         |
| 2 | Koha e gjate deri ne pervesimin e njohurive | 7  | Niveli i ulet i kualifikimit te arsimtareve                            |
| 3 | Rrogat e ulta te arsimtareve                | 8  | Kerkesa e arsimtareve per shperblime nga nxenesit dhe prinderit e tyre |
| 4 | Numri i madh i nxenesve ne klasa            | 9  | tjeter   |
| 5 | Menyra e vleresimit(me nota nga 1-10)       | 10 | Nuk kam mendim te percaktuar   |

Kerkesa e mesuesve per marrjen e shperblimeve nga nxenesit dhe prinderit shikohet gjithashtu si nje e mete e sistemit te sotem arsimor nga rreth 29 % e te intervistuarve. Ndersa niveli i ulet profesional i arsimtareve dhe kriteret e pabarabarte te vleresimit te nxenesve shikohen si mangesi respektivisht 25 dhe 23 % e te anketuarve. Menyra e vleresimit te nxenesve dhe koha e pervesimit te njohurive nuk shikohet si nje magesi serioze e sistemit te sotem arsimor, pasi jane permendur vetem nga 8 dhe 4 % e te anketuarve.

Tabela 4: Opinioni sipas gjinise mbi mangesite qe shfaqen ne sistemin e sotem arsimor

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Meshkuj	69%	3%	62%	64%	7%	22%	23%	27%	0.4%	0.4%
Femra	63%	5%	49%	67%	10%	24%	28%	30%	0.3%	1%


Shenim: Mund te zgjidhen deri ne 3 pergjigje  
Burimi: Qkzh, Tirane

Meshkujt shikojne si nje problem me serioz problemin e paisjeve te dobet te shkollave, ndersa tek femrat problem me i rendesishem konsiderohet numri i nxenesve ne klasa. Diference te madhe ne mendim ndermjet femrave dhe meshkujve ndahet sidomos ne ceshtjen e rrogave te ulta te arsimtareve, ku te meshkujt ky problem permendet nga 62 %, ndersa tek femrat nga 49 %.

Si perfundim per kete seksion do te theksonim, te intervistuarit vleresimin per sistemin e sotem arsimor e lidhin me teper me sigurine qe u krijon ai per pune si dhe per vlerat edukuese te tij. Ndersa si dobesi me te theksuara shikohen vecanarisht ne paisjen e dobet te shkollave dhe numri i madh i nxenesve ne shkolla. Meshkujt shikojne gjithashtu si problem te rendesishem shperblimin e ulet te arsimtareve.

### 3.4 Politika dhe konkurueshmeria

Mbi 90 % e te anketuarve mendojne se politika i kushton pak ose aspak vemendje reformes arsimore. Vetem 4 % e te anketuarve mendojne se vemendja e politikës ndaj reformes arsimore eshte e mjaftueshme.




Burimi: Qkzh, Tirane

Tabela 5: Opinioni sipas gjinise mbi vemendjen qe i kushton politika reformes arsimore

	Mjaftueshem	Pak	Aspak	Nuk e di
Meshkuj	4%	36%	57%	3%
Femra	5%	44%	45%	6%

Burimi: Qkzh, Tirane

Me kritik ne kete drejtim duken se jane meshkujt, pasi 57 % e tyre mendojne se politika nuk i kushton aspak vemendje reformes arsimore, kundrejt 45 % qe eshte pergjigja e femrave.



Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 12 tregon pergjigjet e pyetjes ne lidhje me cilesine e programit aktual arsimor, dhe nese ky program i ploteson kushtet per te qene konkurues jashte vendit. Nga figura 12 shikohet se 63 % e te anketuarve mendojne se programi mesimor aktual nuk eshte ne cilesine e duhur qe te jete konkurues jashte vendit. Vetem 27 % e te anketuarve kane mendim te kundert dhe mendojne se keto programe jane konkuruese, ndersa 10 % e te anketuarve nuk kane ndonje opinion te vecante per kete pyetje.

Edhe ne kete rast me kritik per cilesine e programeve mesimore duket se jane meshkujt pasi 66 % e tyre mendojne se cilesia e programeve nuk eshte e mire qe te lejoje konkurueshmerine e programeve tona arsimore (shiko tabelen 6), Ndersa jane 59 % e femrave qe ndajne nje mendim te tille. Grupi tjetër i femrave eshte me pozitive gjithashtu per cilesine e programeve pasi jane 31 % e tyre qe mendojne se cilesia eshte e mire dhe lejon konkurueshmerine, kundrejt 22 % te meshkujve.

Tabela 6: Opinioni sipas gjinise mbi cilesine dhe konkurueshmerine jashte vendit e programeve arsimore

	Po	Jo	Nuk e di
Meshkuj	23%	66%	11%
Femra	31%	59%	10%

Burimi: Qkzh, Tirane


Si perfundim mund te thuhet se opinioni i pergjithshem i te intervistuarve (afersisht 90% e tyre) mendojne se politika i kushton pak ose aspak vemendje reformes arsimore. Po keshtu rreth 63% e te anketuarve mendojne se cilesia e sistemit te sotem arsimor nuk eshte e tille qe te lejoje konkurueshmerine jashte vendit.

### 3.5 Ngarkesa mesimore

Ngarkesa e nxenesve ne mesime eshte nje nga ceshtjet me te rendesishme te reformes se sotme mesimore. Kjo pyetje i eshte drejtuar publikut e ndare sipas cikleve te ndryshme te shkollimit, gje e cila te mundeson te jepen konkluzione me te sakta.

Ne lidhje me ngarkesen mesimore ne ciklin e ulet mesimor, 72 % e te anketuarve mendojne se ajo eshte e ngarkaur dhe mjaft e ngarkuar (shiko figruen 13). Vetem 12 % e te anketuarve mendojne se nuk ka ngarkese mesimore per ciklin e ulet.

Pare ky aspekt nga dy grupet sipas gjinise (tabela 7) shikohet se jane meshkujt ata qe mendojne se cikli fillor eshte me i ngarkuar.




Burimi: Qkzh, Tirane

Tabela 7: Opinioni sipas gjinise mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e fillores

	Mjaft te ngarkuar	Te ngarkuar	Jo te ngarkuar	Nuk e di
Meshkuj	45%	31%	11%	13%
Femra	42%	27%	12%	19%

Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 14 tregon se ne rastin e ciklit te larte te shkolles 8-vjecare, ata qe mendojne se ngarkesa mesimore eshte e larte dhe shume e larte jane 60 %, e cila ehste me e ulet se ajo qe jane shprehur per ciklin e ulet. Per me shume shikohet se pjesa me e madhe ketij grupi ose 39 % e tyre theksojne se ajo eshte e ngarkuar dhe vetem 21 % mendojne se ajo eshte shume e ngarkuar, perkundrejt 43% qe thone se cikli fillor eshte majft i ngarkuar dhe 29% e ngarkuar (shiko figuren 13).



Burimi: Qkzh, Tirane


Edhe ne rastin e ciklit te larte te shkolles 8-vjecrae jane meshkujt ata qe mendojne se ngarkesa mesimore eshte e larte kundrejt femrave, prej te cilave vetem 19 % e tyre mendojne se femijet jane shume te ngarkuar kundrejt 24 % te meshkujve.

Tabela 8: Opinioni sipas gjinise mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e dyte te 8-vjecares

	Mjaft te ngarkuar	Te ngarkuar	Jo te ngarkuar	Nuk e di
Meshkuj	24%	42%	18%	16%
Femra	19%	36%	22%	23%

Burimi: Qkzh, Tirane

Rezultatet jane te ndryshme edhe per ngarkesen mesimore per shkollat e mesme te pergjithshme. Nga figura 16 shikohet se 46 % e te anketuarve mendojne se shkolla e mesme e pergjithshme eshte mjaft e ngarkuar, dhe se bashku me opinionin e atyre qe mendojne se eshte e ngarkuar shkojme ne shifren 70 % te te anketuarve. Per shkollen e mesme te pergjithshme vetem 11% e te anketuarve mendojne se ajo nuk eshte e ngarkuar, ndersa jane edhe 19% te tjere qe nuk kane ndonje opinion per kete ceshtje.



Burimi: Qkzh, Tirane

Opinionit e femrave dhe meshkujve per kete ceshtje eshte pothuajse i njejte (shiko tablen 9).

Tabela 9: Opinioni sipas gjinise mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per shkollat e mesme te pergjithshme


	Mjaft te ngarkuar	Te ngarkuar	Jo te ngarkuar	Nuk e di
Meshkuj	46%	24%	13%	17%
Femra	47%	23%	10%	20%

Burimi: Qkzh, Tirane

Si perfundim per kete pjese te anketimit do te theksonim, se te anketuarit mendojne se cikli i ulet i shkolles 8 vjecare dhe shkolla e mesme e pergjithshme kane ngarkesen me te madhe mesimore, kundrejt ciklit te larte te shkolles 8-vjecare. Perqindja e atyre qe thone se shkolla eshte mjaft e ngarkuar lidhet me ngarkesen mesimore te shkolles se mesme te pergjithshme. Meshkujt dhe femrat ndajne pothuajse te njeitin mendim per shkollen e meseme te pergjithshem, ndersa meshkujt mendojne se shkolla 8 vjecare ne te dy ciklet eshte me e ngarkuar, perkundrejt mendimit te femrave.

### 3.6 Kushtet e mesimdhenies, shperblimi dhe financimi

Ne shkalle vendi duket se numri mesatar i nxenesve 20 per nje mesues duket qe eshte shume i kenaqshem per opinionin publik, pasi 70 % e tyre mendojne se ky numer nuk duhet te ndryshoje (shiko figuren 16).



Burimi: Qkzh, Tirane


Per me shume 25 % e te anketuarve mendojne se ky numer duhet te jete akoma edhe me i vogel, kundrejt vetem 4 % qe mendojne se ky numer duhet te jete me i madh.

Si ralle ne pyetjet e meparshme, pothuajse nuk ekzistojne diferenca ndermjet opinionit te femrave dhe meshkujve (shiko tabelen 10).

Tabela 10: Opinioni sipas gjinise mbi vleresimin per numrin 20 nxenes per nje mesues

	Te mos ndryshoje	Me i madh	Me i vogel	Nuk e di
Meshkuj	70%	4%	25%	1%
Femra	69%	4%	25%	2%

Burimi: Qkzh, Tirane



Burimi: Qkzh, Tirane

Pjesa dermuese e te anketuarve ose 93 % e tyre mendojne se mesuesit nuk jane te shperblyer sa duhet per punen e tyre. Vetem 5 % e te anketuarve mendojne se mesuesit marrin shperblimin e duhur per kushtet aktuale ekonomike.


Tabela 11 tregon se 95 % e meshkujve mendojne se mesuesit nuk jane te shperblyer sa duhet, kundrejt 92 % te femrave.

Tabela 11: Opinioni sipas gjinise mbi vleresimin per shperblimin e mesuesit per punen e kryer

	Po, per kushtet e sotme ekonomike	Nuk jane te shperblyer sa duhet	Nuk e di
Meshkuj	4%	95%	1%
Femra	5%	92%	3%

Burimi: Qkzh, Tirane

Edhe per rastin e trajnimeve, pjesa me e madhe e te anketuarve mendojne se mesuesit kane nevojte te marrin trajnim te vazhdueshem. Vetem 2 % e te anketuarve mendojne te kunderten. Po keshtu nuk ka ndryshim ne opinion ndermjet meshkujve dhe femrave per kete ceshtje (shiko tabelen 12).




Burimi: Qkzh, Tirane

Tabela 12: Opinioni sipas gjinise mbi nevojat per trainim te vazhdueshem e arsimtareve

	Po	Jo	Nuk e di
Meshkuj	96%	2%	2%
Femra	97%	2%	1%

Burimi: Qkzh, Tirane

Ceshtje tjeter ku pothuajse te gjithë te anketuarit ndajne te njejtin mendim eshte problemi i paisjes me te mire te shkollave me materile didaktike si laboratore etj, pasi 97 m% e tyre mendojne se ato jane mjaft te nevojshme per nje reforme te sukseshme arsimore. Vetem 1 % e te anketuarve mendojne te kunderten, pjesa me e madhe e te cileve duhet te jene meshkuj (shiko tablen 13).



Burimi: Qkzh, Tirane




Tabela 13: Opinioni sipas gjinise mbi vleresimin e bazes materiale-didaktiko si nje kusht i rendesishem per nje reforme te sukseshme arsimore

	Po	Jo	Nuk e di
Meshkuj	97%	2%	1%
Femra	97%	1%	2%

Burimi: Qkzh, Tirane

Figurat 20, 21 dhe 22 tregojne se 91 % e te anketuarve mendojne se duhet te rritet numri i kopshteve dhe 89 % e tyre mendojne respektivisht se duhet te rriten edhe numri i shkollave 8-


vjecare dhe atyre te mesme te pergjithshme. Vetem 2-3 % e te anketuarve mendojne te kunderten, ndersa pjesa tjeter nuk ka ndonje opinion te vecante per kete ceshtje.



Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 23 tregon rezultatet e pergjigjeve ne lidhje me numrin e nxenesve ne nje klase ne kushte optimale. Sic shikohet pothuajse te gjithe ndajne mendimin se numri i nxenesve ne nje klase duhet te jete me i vogel se 30 nxenes.





Burimi: Qkzh, Tirane

Pjesa me e madhe e te anketuarve, ose rreth 50% e tyre mendojne se ne kushte optimale numri i nxenesve ne nje klase duhet te varioje ndermjet 16-20 nxenes, 28 % mendojne se duhet te jene 21-25 nxenes, 5 % e tyre mendojne se duhet te jene 26-30 nxenes dhe 17 % e te anketuarve mendojne se ne klase nuk duhet te kete me shume se 15 nxenes.


Nga tabela 14 duket se mendime me ekstreme kane meshkujt, pasi vetem 16 % e femrave mendojne se duhet te kete me pak se 15 nxenes ne nje klase, kundrejt 19 % te meshkujve. Po keshtu 30 % e femrave mendojne se numri optimal i nxenesve duhet te jete 21-25 nxenes ne nje klase.

Tabela 14: Opinioni sipas gjinise mbi vleresimin per numrin e nxenesve ne nje klase ne kushte optimale

	Deri ne 15	16-20	21-25	26-30	31-40	Mbi 40	Nuk e di
Meshkuj	19.0%	49.6%	26.0%	5.0%	0.4%	0.0%	0.0%
Femra	15.7%	49.0%	30.0%	5.0%	0%	0%	0.3%

Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 24 tregon opinionin e te anketuarve ne lidhje me burimet nga duhet te financohet shkolla. Nga figura duket qarte se vetem se nje numer i vogel, ose 8 % e te anketuarve mendojne se shkolla duhet te financohet vetem nga burimet e bashkise apo burimet private (nepermjet rritjes se shkollave private).



Burimi: Qkzh, Tirane

Dicka me shume se gjysma e te anketuarve ose 51 % mendojne se shkolla duhet te financohet nga burime te perziera dhe pjesa tjetere ose 39 % mendojne se ajo duhet te financohet vetem nga burimet e buxhetit te shtetit.


Tabela 15 tregon ndryshimet e opinioneve te kesaj pyetje sipas gjinise. Ndryshim ne fondet e perziera ku femrat jane 55% kundrejt 47% te meshkujve qe mendojne kete lloj burimi financimi. Meshkujt duket se jane me teper per burimin e financimeve nga buxheti qendror.

Tabela 15: Opinioni sipas gjinise mbi burimet nga duhet te financohet shkolla

	Nga fondet e bashkise	Buxheti i shtetit	Burime te perziera	Rritja e shkollave private	Nuk e di
Meshkuj	8%	42%	47%	2%	1%
Femra	5%	35%	55%	1%	4%

Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 25 tregon se 96 % e te anketuarve mendojne se nga buxheti i shtetit duhet te financohen me shume se 10 % e fondeve, qe aktualisht jane vene ne dispozicion. Vetem 1,3 % e te anketuarve mendojne se ato mjaftojne.



Burimi: Qkzh, Tirane


Si konkluzione per kete pjese te rendesishme te raportit mund te thuhet se:

- § Mbi 70 % e te anketuarve mendojne se duhet te kete 1 mesues per me pak se 20 nxenes.
- § Mbi 93 % e te anketuarve mendojne se mesuesit nuk jane te shperblyer sa duhet.
- § Mbi 96 % e te anketuarve mendojne se mesuesit duhet te marrin trajnime te vazhdueshme
- § Mbi 97 % e te anketuarve mendojne se paisja e shkollave me bazen e nevojshme materialo-didaktike eshte kusht i rendesishem per nje reforme te sukseshme arsimore.
- § Mbi 90 % e te anketuarve mendojne se duhet te rritet numri i kopshteve dhe shkollave 8-vjecare dhe te mesme te pergjithshme.
- § Pothuajse 100 % e te anketuarve mendojne se numri i nxenesve ne nje klase duhet te jete me i vogel 30 nxenes. Pjesa me e madhe e te anketuarve mendojne se ky numer duhet te varioje ne 16-25 nxenes per nje klase.
- § Vetem 7 % e te anketuarve mendojne se shkollat duhet te financohen nga burimet e buxhetit lokal apo private. Pjesa me e madhe e tyre preferojne qe shkolla te financohet nga burime te perziera.
- § Rreth 96 % e te anketuarve mendojne se per arsimin duhet te alokohen me shume se 10 % e totalit te shpenzimeve buxhetore.

### 3.7 Drejtimi i shkollave, sistemi dhe dy-punesimi

Puna e drejtuesve të shkollave është një element kyç i reformës mesimore, pasi është një nga hallkat më të rëndësishme ku transferohet e gjithë politika dhe strategjia për ndryshimet e reformës arsimore në praktike. Element tjetër i rëndësishëm i punës së drejtuesve të shkollave është garantimi i cilësisë së zbatimit të programeve mesimore, mbikqyrja dhe relazimi i trajnimit të stafit pedagogjik, si dhe realizimi i një programi unik të mesimdhënieve në baze të kriterëve dhe programeve të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në figurën 26 pasqyrohen rezultatet mbi opinionin e të intervistuarve se si drejtuesit e shkollave organizojnë dhe drejtojnë punën. Nga figura duket se në këtë rast opinionin e qytetarëve është ndarë gjysëm-përgjysëm, pasi 50% e të anketuarve mendojnë se drejtuesit e shkollave e drejtojnë mirë dhe shumë mirë punën, ndërsa gjysma tjetër mendojnë se e drejtojnë jo mirë, keq, ose nuk kanë opinion për këtë çështje.



Më kritik për drejtimin e shkollave janë meshkujt pasi prej tyre vetëm 49% kanë mendim pozitiv, ndërsa tek femrat ky tregues është 52% (shiko tabelën 16).

Tabela 16: Opinioni sipas gjinisë mbi vlerësimin se si e organizojnë dhe e drejtojnë punën drejtoret e shkollave

	Shume mire	Mire	Jo mire	Keq	Nuk e di
Meshkuj	5%	44%	39%	9%	3%
Femra	6%	46%	31%	10%	7%





Figura 27 tregon se 95% e të gjithë të intervistuarit mendojnë se për caktimin e drejtoreve të shkollave duhet të përdoret konkurimi. Vetëm 3% e të intervistuarve mendojnë se drejtoret e shkollave duhen të emërohen pa konkurim.


Figura 28 tregon se të intervistuarit preferojnë më tepër sistemin e detyruar arsimor 10-vjeçar, pasi 55% e tyre kanë këtë opinion, kundërshtojnë 25% që mendojnë se sistemi 8-vjeçar është më i miri dhe

19% qe mendojne se eshte sistemi 9 vjecar me i miri. Ky i fundit eshte edhe sistemi qe do te aplikohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkences ne vitin e ardhshem mesimor, por qe per mendimin e te anketuarve ata mendojne se ky sistem duhet te jete me i gjate se 9 vjet.



Ceshtja e fundit qe u trajtua gjate anketimit ishte problemi i dy-punesimit te arsimtareve. Megjithese dy-punesimi i arsimtareve nuk eshte nje ceshtje qe ka pengesa ligjore, ajo po trajtohet gjeresisht nga opiniononi publik, sidomos kur behet fjale ne kurset apo aktivitetet e tjera qe kryen nje arsimtar kundrejt nje pagese suplementare. Megjithate pyetja qe u shtua ne kete anketimit nuk specifikonte llojin e punes se dyte te arsimtareve, por thjesht qe si ndikon dy-punesimi ne mesimdhenie.

Figura 29 tregon se 85 % e te anketurave mendojne se dy-punesimi ka ndikim jo te mire ne mesimdhenie, 4 % mendojne se ka ndikim te mire dhe 8 % e tyre mendojne se dy-punesimi nuk ka ndikim.



Si konkluzione te ketij seksioni vecojme:

- § Opinioni i te anketurave per drejtimin e shkollave nga drejtoret eshte pothuajse i ndare ne menyre te barabarte, pasi gjysma e tyre mendojne se ky drejtim eshte i mire dhe shume i mire, ndersa pjesa tjeter nuk eshte e kenaqur nga ky drejtim.
- § Pjesa me e madhe e te intervistuarve, ose 95 % e tyre, mendojne se drejtoret e shkollave duhet te caktohen me konkurim dhe jo me emerim.
- § Te inervistuarit duket se preferojne nje sistem te detyrueshem arsimor pak me te gjate se ai qe ka menduar Ministria e Arsimit, pasi preferenca e tyre eshte per nje arsim 10 vjecar, kundrejt atij 9 vjecar qe duket se ka zgjedhur ministria perkatese.
- § Rreth 85 % e te inetrvistuarve mendojne se dy-punesimi i arsimtareve ka ndikim jo te mire ne mesimdhenie.


### Opinionit i arsimitareve dhe nxenesve

#### 4.1 Hyrje

Ne kete kapitull do te pasqyrohen rezultatet e pergjigjeve per dy kategori te vecanta te te intervistuarve dhe pikerisht per punonjesit e arsimit, nxenesit dhe studentet. Kjo perzgjedhje u be per arsye se keto dy grupe jane nje kategori e vecante e te anketuareve pasi jane ata qe lidhen drejperdrejt me mbarrvejtjen, zbatimin dhe perfitimin e rezultateve te reformes arsimore. Perzgjedhja e ceshtjeve qe do te trajtohen ne kete kapitull u be duke patur parasysh rendesine qe ka nxjerja e opinionit te mesuesve dhe nxenesve per kategori te ndryshme pyetjesh, si dhe u perzgjodhen ato pyetje ku opinionit i ketyre dy kategorive eshte ne menyre te dukshme i ndryshem nga opinionit i pergjithshem i te intervistuarve te paraqitur ne kapitullin e trete te ketij studimi. Pra, per ceshtjet qe nuk jane trajtuar ne kete kapitull do te thote se sjellin pothuajse te njejtin opinion me ato te kategorive te tjera te panelit te perzgjedhur.

#### 4.2 Informimi, vlerat dhe dobesite e sistemit te sotem arsimor

Figura 30 tregon se pjesa me e madhe e punonjesve te arsimit, ose rreth 80 % e tyre jane te informuar mire ose mjaftueshem rreth reformes arsimore ne Shqiperi. Vetem 19 % e tyre kane pak ose aspak informacion rreth reformes arsimore.



Burimi: Qkzh, Tirane

Tabela 17: Opinionit i nxenesve/studenteve mbi shkallen e informimit per reformen arsimore ne Shqiperi

	I mire informuar	Mjaftueshem	Pak	Aspak
Nxenes/studente	8%	40%	41%	11%


Burimi: Qkzh, Tirane

Tabela 17 tregon se pothuajse gjysma e nxenesve kane pak ose aspak informacion per reformen arsimore. Por 40 % e nxenesve kane informacion te mjaftueshem per reformen arsimore, ndersa vetem 8 % e tyre jane te mireinformuar.

Diferenca ne mireinformim ndermjet mesuesve dhe nxenesve tregon se mesuesit nuk kane zhvilluar akoma forma kolektive te informimit te nxenesve per kete reforme.

Figura 31 tregon burimin e informacionit te punonjesve te arsimit per reformen arsimore. Sic shihet edhe nga figura edhe per punonjesit e arsimit burimet kryesore te marrjes se informacionit jane shtypi dhe televizioni. Forma te tjera te informacionit qe presupozohen te jete njoftime te minsitrise

apo drejtorive arsimore jane mjaft te ulta, deri ne 8 %, e cila eshte edhe me ulet nga burimi i informacionit qe jane femijet e vete punonjsve te arsimit.



Burimi: Qkzh, Tirane  
Shenim: mund te zgjidhet me shume se nje pergjigje


Per nxenesit dhe studentet burimi kryesor i informacionit eshte televizioni (shiko tabelen 18). Burimi i dyte i rendesishem eshte kontakti me mesuesit.

Tabela 18: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi burimet e informacionit per reformen ne arsim

	Nga femijet tuaj	Nga kontakti me mesuesit	Nga te njohurit	Nga shtypi	Nga televizioni	Te tjera
Nxenes/studente	0%	37%	25%	34%	66%	0.0%

Burimi: Qkzh, Tirane  
Shenim: mund te zgjidhet me shume se nje pergjigje

Nga perpunimi i te dhenave ne lidhje me burimet e marrjes se informacionit nga ana e mesuesve dhe nxenesve, del se burimi kryesor i informacionit eshte media e shkruar a vizive, dhe me sa duket pak forma te drejperdrejta perdoren nga organet e specializuara per kete qellim.



Shenim: Mund te zgjidhen deri ne 2 pergjigje  
Burimi: Qkzh, Tirane

**Legjenda**

- |                           |  |                             |
|---------------------------|--|-----------------------------|
| 1 Shkollimi i lire        | 4 Ndikimi i madh i shkolles ne edukimin e brezit te ri | 6 Te tjera                  |
| 2 Arsim i gjere dhe masiv | 5 E ardhme e sigurte pune                              | 7 Nuk kam mendim te vecante |
| 3 Programi i mire arsimor |  |                             |


Punonjesit e arsimit vleresojne ndikimin e arsimit ne edukimin e brezit te ri dhe mundesine qe te siguron ajo pune si dy nga vlerat me te rendesishme te sistemit te sotem arsimor (shiko figuren 32). Megjithate punonjesit e arsimit vleresojne edhe faktin se arsimimi eshte i gjere dhe masiv dhe programin e mire arsimor si vlera te ketij arsimit.

Tabela 19: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi vlerat e sotme te sistemit arsimor

	1	2	3	4	5	6	7
Nxenes/studente	25%	31%	18%	32%	32%	0%	11%

Shenim: Mund te zgjidhen deri ne 2 pergjigje  
Burimi: Qkzh, Tirane

Opinioni i nxenesve eshte me i shpendare ndermjet vlerave te tilla si ndikimi ne edukim, siguria e punes, arsimit i gjere dhe masiv dhe dicka me poshte shkollimi relativisht i lire (shiko tabelen 19).



Shenim: Mund te zgjidhen deri ne 3 pergjigje  
Burimi: Qkzh, Tirane

Legjenda:

1	Paisja e dobet e shkollave	6	Kriteri i pabarabarte i vleresimit te nxenesve
2	Koha e gjate deri ne pervetesimin e njohurive	7	Niveli i ulet i kualifikimit te arsimtareve
3	Rrogat e ulta te arsimtareve	8	Kerkesa e arsimtareve per shperblime nga nxenesit dhe prinderit e tyre
4	Numri i madh i nxenesve ne klasa	9	Te tjera
5	Menyra e vleresimit (me nota nga 1-10)	10	Nuk kam mendim te percaktuar

Pjesa dermuese e arsimtareve, ose 88 % e tyre, mendojne se mangesia themelore e sistemit te sotem arsimor jane pagat e ulta te arsimtareve (shiko figuren 33). Dy faktore te tjere, pothuajse po kaq te rendesishem konsiderohen numri i madh nxenesve ne klasa (78 %) dhe paisja e dobet e shkollave (76%). Rreth 22 % e punonjesve te arsimit mendojne gjithashtu se ekziston nje nivel i ulet i kualifikimit te arsimtareve qe konsiderohet si nje mangesi e sistemit te sotem te arsimit. Kerkesa e arsimtareve per te marre shperblime nga prinderit dhe nxenesit nuk konsiderohet si e mete nga asnje prej te anketuarve.

Tabela 20: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi mangesite qe shfaqen ne sistemin e sotem arsimor

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Nxenes/studente	67%	4%	37%	57%	27%	40%	26%	21%	2%	1%

Shenim: Mund te zgjidhen deri ne 3 pergjigje  
Burimi: Qkzh, Tirane

Nga tabela 20 shikohet se nxenesit dhe studentet duket se jane sensitive per paisjen e dobet te shkollave, pasi 67 % e tyre e ka cilesuar kete aspekt si te meten kryesore. Si mangesi te dyte konsiderojne numrin e madh te nxenesve ne klasa (57 %). Por nxenesit kane me shume pretendime dhe shikojne si te mete te mesimesdhenies se sotme perdorimin e pabarabarte te vlresimit te tyre (40 %) dhe vetem 37 % konsiderojne rrogat e ulta te arsimitareve. Po keshtu nxenesit duket se jane sensitive edhe per nivelin e ulet te arsimitareve (26 %) dhe konsiderojne si te mete me te parendesishme kerkesen per shperblime te mesuesve (21 %).

Punonjesit e arsimit jane me pozitive per cilesine dhe konkurueshmerine e programeve mesimore. Kjo pasi 49 % e tyre mendojne se keto programe jane cilesore dhe konkuruese (shiko figuren 34), ndersa 46 % e tyre kane mendim te kundert.




Tabela 21: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi cilesine dhe konkurueshmerine jashte vendit e programeve arsimore

	Po	Jo	Nuk e di
Nxenes/studente	25%	61%	14%

Burimi: Qkzh, Tirane

Nxenesit dhe studentet jane me shume kritike per cilesine dhe konkurueshmerine e programeve mesimore, kjo pasi 61 % e tyre mendojne se ato nuk jane cilesore sa te lejojne konkurrueshmerine per jashte vendit (shiko tablen 21). Vetem 25 % te tyre jane pozitive rreth kesaj ceshtje.


Si konkluzione te ketij seksioni do te theksonim sa me poshte vijon:

- § Mesuesit dhe deri diku nxenesit jane me te mireinformuar per reformen arsimore.
- § Burimi kryesor i informimit per te dy keto grupe te rendesishme mbetet media e shkruar dhe ajo vizive. Per nxenesit dhe studentet mesuesit jane nje tjeter burim i rendesishem i informimit, ndersa per keta te fundit duket se mungojne kanalet e komunikimit ndermjet trupes pedagogjike, drejtorive arsimore dhe ministrise perkatese.
- § Punonjesit e arsimit ndajne pothuajse te njetin mendim me grupet e tjera te intervistuarve ne lidhje me vlerat e sistemit te sotem arsimor. Ata vleresojne dicka me shume programet e mira arsimore. Nxenesit kane nje shperndarje me uniforme ndermjet vlerave te ndryshme te sistemit te sotem arsimor.
- § Per mbi 75 % e arsimitareve mendojne se arsimi ka 3 te meta kryesore, rrogat e uleta, numrin e madh te nxenesve ne klasa dhe paisjen e dobet te shkollave, ndersa nxenesit duket se kane me shume problem paisjen e dobet te shkollave dhe dicka me pak, numri e nxenesve ne klasa.
- § Pothuajse gjysma e arsimitareve mendojne se sistemi i sotem arsimor eshte cilesor dhe per rrjedhoje konkurues per jashte shtetit, ndersa nxenesit nuk ndajne nje mendim te tille, pasi rreth 2/3 e te intervistuarve kane mendim te kundert.



### 4.3 Opinion i mesuesve/nxenesve per ngarkesen mesimore

Nga figura 35 shikohet se rreth 50 % e mesuesve mendojne se cikli i fillores eshte i ngarkuar ose mjaft i ngarkuar, ndersa 12 % e tyre mendojne te kunderten. Jane rreth 27 % e te pyeturve te ketij grupi te cilet nuk kane ndonje mendim te percaktuar per kete ceshtje. Keto rezultate jane rreth 20 % me te uleta se mesatarja e pergjigjeve te marra nga gjithe grupi i te intervistuarve.




Ne pothuajse te njetin mendim jane edhe nxenesit dhe studentet, pasi 56 % e tyre mendojne se cikli i fillores eshte mjaft i ngarkuar ose i ngarkuar, ndersa 22 % thone te kunderten.

Tabela 22: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e fillores

	Mjaft te ngarkuar	Te ngarkuar	Jo te ngarkuar	Nuk e di
Nxenes/studente	24%	32%	22%	22%

Burimi: Qkzh, Tirane

Arsimtarët mendojnë se cikli i lartë i shkollës 8-vjeçare është më i ngarkuar se ai i fillor, pasi 76 % e tyre mendojnë se ky cikël është i ngarkuar ose mjaft i ngarkuar. Vetëm 12 % e të anketuarve të këtij grupi kanë mendim të kundërt. Krahasuar me rezultatet e përgjithshme rreth kësaj pyetje, mesuesit janë në % më të lartë se mesatarja e përgjithshme.




Nxenesit nuk ndajnë të njëjtin mendim me mesuesit, pasi janë vetëm 53 % e tyre që kanë mendim të njëjtit, ndersa 27 % e tyre kanë mendim të kundërt (shiko tabelën 23).

Tabela 23: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per ciklin e dyte te 8-vjecares

	Mjaft te ngarkuar	Te ngarkuar	Jo te ngarkuar	Nuk e di
Nxenes/studente	12%	42%	27%	19%

Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 37 tregon se rreth 56 % e arsimitareve mendojne se progarmi i shkollave te mesme te pergjithshme eshte mjaft i ngarkuar, dhe duke i shtuar ketu edhe ata qe mendojne se eshte i ngarkuar, shikohet se punonjesit e arsimit jane te mendimit se shkolla e mesme e pergjithshme eshte me e ngarkuara nga pikepamja e programeve mesimore.



Burimi: Qkzh, Tirane

Edhe nxenesit e studentet ndajne ne kete rast te njejtin mendim me mesuesit e tyre, rreth 92 % e tyre theksojne se ky cikel eshte mjaft i ngarkuar ose i ngarkuar (shiko tabelen 24).

Tabela 24: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi ngarkesen e nxenesve ne lidhje me programin mesimor per shkollat e mesme te pergjithshme


	Mjaft te ngarkuar	Te ngarkuar	Jo te ngarkuar	Nuk e di
Nxenes/studente	69%	23%	4%	4%

Burimi: Qkzh, Tirane

Si konkluzion per kete seksion mund te thuhet se opinioni i mesuesve dhe nxenesve ne pergjithesi perputhet me ate te grupeve te tjera ne ngarkesen e larte per shkollen e mesme te pergjithshme. Ndersa ka disa diferenca ne dy ciklet e shkolles 8-vjecare.

#### 4.4 Numri i nxenesve dhe puna drejtuese

Rreth 50 % e punonjsve te arsimit mendojne se numri optimal i nxenesve ne klasa duhet te jete nga 21-25 nxenes dhe 32 % e tyre nga 16-20 (shiko figuren 38). Krahasuar me rezultatet e pergjithshme shikohet se mesuesit shikojne si me te drejte numrin e nxenseve 21-25, kur rreth 50 % e te intervistuarve mendonin se numri me i pershtatshem do te ishte 16-20 nxenes.



Burimi: Qkzh, Tirane


Tabela 25 tregon se nxenesit dhe studentet preferojne te jene ne nje numer me te vogel ne klase nga sa mendojne mesuesit e tyre, pasi 44 % e tyre mendojne se numri me i pershtshem do te ishte 16-20, ndersa 34 % e tyre mendojne per 21-25 dhe vetem 7 % mendojne se numri nxenesve ne klase duhet te jete 26-30.

Tabela 25: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi vleresimin per numrin e nxenesve ne nje klase ne kushte optimale

	Deri ne 15	16-20	21-25	26-30	31-40	Mbi 40	Nuk e di
Nxenes/studente	15%	44%	34%	7%	0%	0%	0%

Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 39 tregon se punonjesit e arsimit kane nje mendim pozitiv per drejtimin dhe organizimin e punes nga drejtoret e shkollave. Kjo pasi 56 % e tyre mendojne se ata e drejtojne punen mire dhe 29 % shume mire. Ndersa jane vetem 13 % e te anketuarve qe mendojne se drejtoret e drejtojne jo mire ose keq shkollen.



Burimi: Qkzh, Tirane


Nxenesit dhe studentet duket se jane me kritik per drejtoret e shkollave ne krahasim me mesuesit e tyre. Kjo pasi, sipas tabelës 26, 57 % e tyre mendojne se ata e drejtojne mire shkollen, ndersa jane rreth 32 % e nxenesve dhe studenteve qe mendojne te kunderten.

Tabela 26: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi vleresimi se si e organizojne dhe e drejtojne punen drejtoret e shkollave

	Shume mire	Mire	Jo mire	Keq	Nuk e di
Nxenes/studente	10%	57%	26%	6%	1%


Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 40 tregon se rreth 95 % e punonjesve te arsimit mendojne se drejtoret e shkollave duhet te caktohen me konkurim, dhe vetem 5 % e tyre mendojne se emerimi eshte me i drejte. Ky rezultat eshte pothuajse i njejte me ate te gjithe te intervistuarve.



Burimi: Qkzh, Tirane

Po keshtu punonjesit e arsimit ndajne te njejten mendim me shumicen e te anketuarve, pasi 54 % e tyre mendojne se sistemi me i mire i detyruar eshte ai 10-vjecar dhe vetem 22 % mendojne se eshte sistemi 9-vjecar, sic parashikohet edhe nga Ministria e Arsimit dhe Shkences (shiko figuren 41).



Burimi: Qkzh, Tirane


Po keshtu edhe mendimi i nxenesve dhe studenteve eshte se sistemi i detyruar 10-vjecar eshte sistemi me i pershtatshem (shiko tabelen 27).

Tabela 27: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi sistemin e detyruar arsimor

	8 vjet	9 vjet	10 vjet	Nuk e di
Nxenes/studente	18%	18%	64%	0%

Burimi: Qkzh, Tirane

Figura 42 tregon se rreth 59 % e punonjesve te arsimit mendojne se dy-punesimi i arsimtareve nuk ndikon mire ne procesin mesimor, ndersa 29 % e tyre mendojne se nuk ka ndikim dhe vetem 12 % e tyre mendojne se eshte mire. Keto te dhena jane disi te ndryshme nga pjesa me e madhe e te intervistuarve te cilet mendojne me ne shumice se dy-punesimi nuk ndikon mire ne mesimdhene.



Burimi: Qkzh, Tirane

Tabela 28 tregon se 83 % e nxenesve dhe studenteve mendojne se dy-punesimi i arsimitareve nuk eshte mire per mesimdhenien, 11 % mendojne se nuk ka ndikim dhe vetem 6 % e tyre mendojne se eshte mire.

Tabela 28: Opinioni i nxenesve/studenteve mbi ndikimin ne mesimdhenie te dy-punesimit te arsimitareve

	Mire	Jo mire	Nuk ka ndikim	Nuk e di
Nxenes/studente	6%	83%	11%	0%

Burimi: Qkzh, Tirane

Si konkluzione per kete seksion do te theksonim sa vijon:

- § Per mesuesit duket se numri me i pershtshem ne klase eshte ai me 21-25 nxenes, ndersa nxenesit dhe studentet mendojne se ky numer duhet te jete edhe me i ulet.
- § Mesuesit kane nje mendim pozitiv per drejtimin e shkollave nga drejtoret, pasi rreth 85 % e tyre mendojne se ata e drejtojne mire ose shume mire shkollen.
- § Rreth 95 % e punonjesve te arsimit qe jane intervistuar mendojne se konkursi eshte forma me e pershtashme per emerimin e drejtoresve.
- § Rreth 54 % e mesuesve mendojne se sistemi arsimor i detyruar me i pershtshem eshte ai 10 vjecar, ndersa 19 % e tyre mendojne se me i pershtshmi eshte ai 9-vjecar.
- § Ne shumicen e tyre punonjesit e arsimit mendojne se dy-punesimi ka ndikim negativ mbi mesimdhenien, megjithese ka rreth 41% te tyre qe mendojne se dy-punesimi nuk ka ndikim ose ka ndikim pozitiv per mesimdhenien.

## Kapitulli i peste

### Konkluzione

Ky projekt kishte per qellim te diagnostikonte si dhe sa publiku shqiptar eshte i njohur me reformen arsimore ne Shqiperi, dobesite te ketij sistemi dhe drejtimet kryesore se ku duhet te nderhyhet me shpejt dhe me pare per te arritur efekte me te madha me burimet ekzistuese financiare. Projekti u mbeshet mbi nje anketim te zgjeruar te rreth 1000 individeve te grup-moshave mbi 18 vjec, te cilat u perzgjedhen ne menyre te rastesishme ne rrethet kryesore te Shqiperise, si Tirane, Durres, Shkoder dhe Elbasani. Anketimi u zhvilluar gjate periudhes 10 Nentor deri me 10 Dhjetor 2003.

Perzgjedhja e kampionit te te anketuarve u krye konform metodologjise se hartuar paraprakisht, e cila duhet te lejonte nje shperndarja te te intervistuarve sipas karakteristikave demografike, por edhe per te lejuar marrjen e opinioneve nga individe, qe jane me afer problemeve dhe reformes ne arsim, duke rritur ne kete menyre pjesemarrjen ne anketim te individeve me arsim te larte dhe te mesem te pergjithshem, duke rritur punonjesit e arsimit, dhe duke rritur pjesemarrjesit nga zonat urbane.

Konkluzionet kryesore qe dolen nga analiza e te dhenave mbas anketimit ishin keto:

#### *A. Rezultatet e pergjithshme*

- Ø Me shume se gjysma e te intervistuarve nuk kane informimin e mjaftueshem per reformen arsimore ne Shqiperi. Ne kete aspekt femrat jane me te informuara se sa meshkujt. Burimi kryesor i marrjes se informacionit nga individet e ndryshem eshte televizioni, dhe me pas shtypi. Kontakti i prinderve me arsimtaret nuk u jep atyre ndonje avantazh ne sigurimin e informacionit per reformen arsimore, burim i cili eshte ne nje nivel edhe me te ulet se informimi nga nxenesit.
- Ø Vleresimin per sistemin e sotem arsimor te intervistuarit e lidhin me teper me sigurine qe u krijon ai per pune si dhe per vlerat edukuese te tij. Ndersa si dobesi te tij dalin ne pah vecanarisht paisja e dobet e shkollave dhe numri i madh i nxenesve ne shkolla. Meshkujt shikojne gjithashtu si problem te rendesishem shperblimin e ulet te arsimtareve.
- Ø Te anketuarit mendojne se cikli i ulet i shkolles 8 vjecare dhe shkolla e mesme e pergjithshme kane ngarkesen me te madhe mesimore, kundrejt ciklit te larte te shkolles 8-vjecare. Perqindja e atyre qe thone se shkolla eshte mjaft e ngarkuar lidhet me ngarkesen mesimore te shkolles se mesme te pergjithshme. Meshkujt dhe femrat ndajne pothuajse te njejtin mendim per shkollen e meseme te pergjithshem, ndersa meshkujt mendojne se shkolla 8 vjecare ne te dy ciklet eshte me e ngarkuar, perkundrejt mendimit te femrave.
- Ø Mbi 70 % e te anketuarve mendojne se duhet te kete 1 mesues per me pak se 20 nxenes.
- Ø Mbi 93 % e te anketuarve mendojne se mesuesit nuk jane te shperblyer sa duhet.
- Ø Mbi 96 % e te anketuarve mendojne se mesuesit duhet te marrin trajnime te vazhdueshme.
- Ø Mbi 97 % e te anketuarve mendojne se paisja e shkollave me bazen e nevojshme materialo-didaktike eshte kusht i rendesishem per nje reforme te sukseshme arsimore.
- Ø Mbi 90 % e te anketuarve mendojne se duhet te rritet numri i kopshteve dhe shkollave 8-vjecare dhe te mesme te pergjithshme.
- Ø Pothuajse 100 % e te anketuarve mendojne se numri i nxenesve ne nje klase duhet te jete me i vogel se 30. Pjesa me e madhe e te anketuarve mendojne se ky numer duhet te varioje ne 16-25 nxenes per nje klase.
- Ø Vetem 7 % e te anketuarve mendojne se shkollat duhet te financohen nga burimet e buxhetit lokal apo private. Pjesa me e madhe e tyre preferon qe shkolla te financohet nga burime te perziera.
- Ø Rreth 96 % e te anketuarve mendojne se per arsimin duhet te alokohen me shume se 10 % e totalit te shpenzimeve buxhetore.
- Ø Opinioni i te anketuarve per drejtimin e shkollave nga drejtoret eshte pothuajse i ndare ne menyre te barabarte, pasi gjysma e tyre mendojne se ky drejtim eshte i mire dhe shume i mire, ndersa pjesa tjeter nuk eshte e kenaqur nga ky drejtim.

- Ø Pjesa me e madhe e te intervistuarve, ose 95 % e tyre, mendojne se drejtoret e shkollave duhet te caktohen me konkurim dhe jo me emerim.
- Ø Te intervistuarit duket se preferojne nje sistem te detyrueshem arsimor pak me te gjate se ai qe ka menduar Ministria e Arsimit, pasi preferenca e tyre eshte per nje arsim 10 vjecar, kundrejt atij 9 vjecar qe duket se ka zgjedhur ministria perkatese.
- Ø Rreth 85 % e te intervistuarve mendojne se dy-punesimi i arsimtareve ka ndikim jo te mire ne mesimdhenie.

### ***B. Opinioni i punonjesve te arsimit dhe nxenesve/studenteve***

- Ø Mesuesit dhe deri diku nxenesit jane me te mireinformuar per reformen arsimore.
- Ø Burimi kryesor i informimit per te dy keto grupe te rendesishme mbetet media e shkruar dhe ajo vizive. Per nxenesit dhe studentet mesuesit jane nje tjetër burim i rendisishem i informimit, ndersa per keta te fundit duket se mungojne kanalet e komunikimit ndermjet trupes pedagogjike, drejtorive arsimore dhe ministrise perkatese.
- Ø Punonjesit e arsimit ndajne pothuajse te njetin mendim me grupet e tjera te te intervistuarve ne lidhje me vlerat e sistemit te sotem arsimor. Ata vleresojne dicka me shume programet e mira arsimore. Nxenesit kane nje shperndarje me uniforme ndermjet vlerave te ndryshme te sistemit te sotem arsimor.
- Ø Per mbi 75 % e arsimtareve mendojne se arsimi ka 3 te meta kryesore, rrogat e uleta, numrin e madh te nxenesve ne klasa dhe paisjen e dobet te shkollave, ndersa nxenesit duket se kane me shume problem paisjen e dobet te shkollave dhe dicka me pak, numri e nxenesve ne klasa.
- Ø Pothuajse gjysma e arsimtareve mendojne se sistemi i sotem arsimor eshte cilesor dhe per rrjedhoje konkurues per jashte shtetit, ndersa nxenesit nuk ndajne nje mendim te tille, pasi rreth 2/3 e te intervistuarve kane mendim te kundert.
- Ø Opinioni i mesuesve dhe nxenesve ne pergjithesi perputhet me ate te grupeve te tjera ne ngarkesen e larte per shkollen e mesme te pergjithshme. Ndresa ka disa difference ne dy ciklet e shkolles 8-vjecare.
- Ø Per mesuesit duket se numri me i pershtshem ne klase eshte ai me 21-25 nxenes, ndersa nxenesit dhe studentet mendojne se ky numer duhet te jete edhe me i ulet.
- Ø Mesuesit kane nje mendim pozitiv per drejtimin e shkollave nga drejtoret, pasi rreth 85 % e tyre mendojne se ata e drejtojne mire ose shume mire shkollen.
- Ø Rreth 95 % e punonjesve te arsimit qe jane intervistuar mendojne se konkursi eshte forma me e pershtshme per emerimin e drejtoreve.
- Ø Rreth 54 % e mesuesve mendojne se sistemi arsimor i detyruar me i pershtshem eshte ai 10 vjecar, ndersa 19 % e tyre mendojne se me i pershtshmi eshte ai 9-vjecar.
- Ø Ne shumicen e tyre punonjesit e arsimit mendojne se dy-punesimi ka ndikim negativ mbi mesimedhenien, megjithese ka rreth 41 % te tyre qe mendojne se dy-punesimi nuk ka ndikim ose ka ndikim pozitiv per mesimdhenien.